



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendim Nr. 41/16
Prishtinë, 06.12.2016

Në mbështetje të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 28 paragrafi 1 pika 1.7, 1.10, neni 29, 32, 34, 35, 38, 54 dhe neni 4 paragrafi 1.4, në mbështetje të LIGJIT Nr. 04/L-226 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 2 paragrafi 2 pika 1.7, në mbështetje të LIGJIT Nr. 05/L-031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE, në mbështetje të STATUTIT të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës Nr. 04-V-312 të datës 02.03.2012, neni 7 paragrafi 1.1, 1.7 dhe neni 8 paragrafi 1.4, 1.5, 1.6 si dhe në mbështetje të VENDIMIT TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS Nr.17/44 i dt. 12.08.2015, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në Mbledhjen e mbajtur më 06.12.2016 merr këtë:

V E N D I M

I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës KONSTATON se:

- a. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet **Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Postës së Kosovës Sh.A.**" me Nr. prot: 01-1696/2015 e nënshkruar me datën 23.07.2015.
- b. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet **Komunës së Prishtinës dhe Postës së Kosovës Sh.A.**" me Nr. prot: 01-031-75225 e nënshkruar me datën 03.04.2015.
- c. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet **Komunës së Gjilanit dhe Postës së Kosovës Sh.A.**" me Nr. 1573 e nënshkruar me datën 28.10.2015.
- d. "Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet **Komunës së Mitrovicës dhe Postës së Kosovës Sh.A.**" me Nr. prot: 01-31-83737 e nënshkruar me datën 15.10.2015.
- e. "Kontrata për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm me qira për ofrimin e shërbimit të pagesave ndërmjet **Komunës së Ferizajt dhe IFJB VLLESA-CO.**" me Nr. prot: 01-206/16 e nënshkruar me datën 08.07.2016.
- f. "Kontratë për qiranë e lokalit afaristë ndërmjet **Komunës së Gjakovës dhe Banka Ekonomike.**" e nënshkruar me datën 25.03.2008.

- të gjitha Marrëveshjet/Kontratat e lartpërmendura në **Pikën I** (a,b,c,d,e,f) **biën** ndesh me LIGJIN PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 4 "Marrëveshjet e Ndaluar" paragrafi 1.4 – "zbatojnë kushte të ndryshme për transaksione të njëjta me ndërmarrje të tjera tregtare, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurruese".

II. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës **kërkon** nga:

- a. **Ministria e Punëve të Brendshme** që ta shfuqizojë “*Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Postës së Kosovës S.H.A.*” me Nr. prot: 01-1696/2015 e nënshkruar me datën 23.07.2015
- b. **Komuna e Prishtinës** që ta shfuqizojë “*Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe Postës së Kosovës S.H.A.*” me Nr. prot: 01-031-75225 e nënshkruar me datën 03.04.2015
- c. **Komuna e Gjilanit** që ta shfuqizojë “*Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Gjilanit dhe Postës së Kosovës S.H.A.*” me Nr. prot: 1573 e nënshkruar me datën 28.10.2015
- d. **Komuna e Mitrovicës** që ta shfuqizojë “*Marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Mitrovicës dhe Postës së Kosovës S.H.A.*” me Nr. prot: 01-31-83737 e nënshkruar me datën 15.10.2015
- e. **Komuna e Ferizajt** që ta shfuqizojë “*Kontratën për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm me qira për ofrimin e shërbimit të pagesave ndërmjet Komunës së Ferizajt dhe VLLESA-CO*” me Nr. prot: 01-206/16 e nënshkruar me datën 08.07.2016.
- f. **Komuna e Gjakovës** që ta shfuqizojë “*Kontratën për qiranë e lokalit afaristë ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Bankës Ekonomike*” të nënshkruar me datën 25.03.2008.

III. Afati për shfuqizimin e këtyre marrëveshjeve është **60 ditë** nga dita e nënshkrimit të këtij vendimi dhe menjëherë të njoftohet me shkrim Autoriteti Kosovar i Konkurrencës për veprimet e ndërmarrura, në të kundërtën Autoriteti Kosovar i Konkurrencës do të detyrohet që të filloj procedurat për **hetim të thelluar**, rrjedhimisht duke vendosur **Masat e përkohshme** sipas nenit 48 të LIGJIT Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS. Mos shfuqizimi i “*Marrëveshjeve*” përbënë rrezik dhe dëmtim të pariparueshëm për konkurrencën e këtij tregu.

IV. **REKOMANDOHET**, Ministria e Punëve të Brendshme, Komuna e Prishtinës Komuna e Gjilanit, Komuna e Mitrovicës, Komuna e Ferizajt, Komuna e Gjakovës si dhe të gjitha Autoritetet shtetërore; qendrore dhe lokale që të ofrojnë kushte të barabarta për transaksionet e njejta me operatorët tjerë ekonomik (IFJB), duke i vendosur ato në gjendje të favorshme konkurruese përmes mekanizmave ligjorë, në respektim të ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ARSYETIM

A. SHQYRTIMI PARAPRAK

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës sipas detyrës zyrtare dhe në bazë të ankesave të IFJB-ve ka filluar shqyrtimin paraprak në tregun relevant.

Objekt i shqyrtimit paraprak:

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak janë Marrëveshja e bashkëpunimit (IFJB) ndërmjet MPB/ARC - Postës së Kosovës Sh.A. dhe Marrëveshjet/Kontratat ndërmjet komunave të Kosovës - Postës së Kosovës Sh.A dhe operatorëve tjerë ekonomik në tregun përkatës.

Institucion financiar jo bankar (IFJB) - është person juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është licencuar nga BQK-ja, (sipas Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare) për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënie e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënie financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktoringun ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operationale, si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja.

IFJB-të (Institucione Financiare Jo Bankare)	
IFJB MONETA Sh.p.k.	IFJB PROPAID Sh.p.k.
IFJB VLLESA CO Sh.p.k.	IFJB CAPITAL Sh.p.k.
IFJB POSTA E KOSOVËS Sh. A.	

Janë institucione të licencuara për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë/aktivitetet vijuese:

- Transfer parash;
- Shërbimi i pagesave;
- Transfere hyrëse/dalëse; Shërbime të pagesave juridike, të dokumenteve personale, të regjistrimit të veturave, të taksave, shërbime tjera të ngjashme si dhe veprimtari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja.

Posta e Kosovës Sh.A. - themelimi

Posta e Kosovës është shoqëri aksionare, e themeluar sipas Ligjit Nr. 03/L-087, Mbi Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe është themeluar si entitet legal me ndarjen e Shoqërisë Aksionare "Posta dhe Telekom i Kosovës" Sh.A. bazuar në vendimin e aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës Nr.16/53 i datës 21.12.2011, vendimit të MZHE-NJPMNP (Njësia për Mbikëqyrjen e Ndërmarrjeve Publike) e datës 21.09.2011.

Posta e Kosovës Sh.A. është e licencuar si IFJB nga Banka Qendrore e Kosovës për kryerjen e këtyre aktiviteteve:

- Shërbimi i pagesave;
- Shërbime të pagesave juridike, të dokumenteve personale, të regjistrimit të veturave, të taksave si dhe shërbime tjera të ngjashme.

B. SHKRESAT DHE KËRKESAT E OPERATORËVE EKONOMIK

1. Me datë 21.09.2015 Autoriteti ka pranuar një kërkesë nga IFJB Moneta - Sh.p.k. të cilën e përfaqëson z. Krenar Mustafa - drejtor, me Kërkesë për Mbrojtjen e Konkurrencës së lirë dhe efektive në Treg kundër Marrëveshjes MPB-Posta e Kosovës Sh.A.
2. Me datë 09.09.2015, Autoriteti ka pranuar një kërkesë nga IFJB PROPAID Sh.p.k të cilën e përfaqëson z. Shkelqim Latifaj – Drejtor, me Kërkesë për Mbrojtjen e Konkurrencës së lirë dhe efektive në Treg kundër Marrëveshjes së Komunës së Prishtinës – Posta e Kosovës Sh.A.
3. Me datë 21.12.2015 Autoriteti ka pranuar një kërkesë nga IFJB VLLESA CO Sh.p.k. të cilën e përfaqëson z. Gani Sallauka – Pronar, me Kërkesë për Mbrojtjen e Konkurrencës së lirë dhe efektive në Treg kundër Marrëveshjes së MPB – Posta e Kosovës Sh.A.
4. Me datë 05.02.2016 Autoriteti ka pranuar një kërkesë nga IFJB CAPITAL Sh.p.k. – të cilën e përfaqëson z. Nusret Hasani – Drejtor Ekzekutiv, me Kërkesë për Mbrojtjen e Konkurrencës së lirë dhe efektive në Treg kundër Marrëveshjes së MPB – Posta e Kosovës Sh.A.

C. PËRCAKTIMI I TREGUT PËRKATËS

Për të gjykuar mbi kufizimin e konkurrencës janë analizuar parametrat e konkurrencës në tregun përkatës dhe përkitazi me këtë kemi përcaktuar tregun përkatës apo tregun e produktit dhe tregun gjeografik, si më poshtë:

Struktura dhe Shtirja e Tregut Relevant është përcaktuar duke iu referuar *nenit 6 të Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe kriteret e përcaktimit të tregut përkatës nr. 02/2011:*

Tregu gjeografik

Tregu gjeografik konsiderohet territori i Republikës së Kosovës.

Tregu i produktit

Tregu përkatës i produktit do të konsiderohet **Ofrimi i Shërbimit të Pagesave të IFJB-ve.**

D. VLERËSIMI, ANALIZIMI I TË GJETURAVE DHE REKOMANDIMET PËRKATËSE GJATË SHQYRTIMIT PARAPRAK TË HETIMIT

Në bazë të gjeturave, gjatë shqyrtimit paraprak të situatës në tregun relevant nga dokumentacioni dhe informacionet e siguruara, kemi konstatuar se Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Postës së Kosovës Sh.A. **ekziston** dhe bie ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 4 paragrafi 1.4.

Në bazë të konstatimit dhe vlerësimit të këtyre Marrëveshjeve kemi evidentuar se si e tillë është duke funksionuar në selinë e Agjencionit të Regjistrimit Civil si dhe në shumicën e Qendrave të Regjistrimit Civil (QRC) dhe në Qendrat e Regjistrimit të Automjeteve (QRA) nëpër Komunat e Kosovës.

Konstatojmë se Marrëveshje të njëjtë Posta e Kosovës Sh.A. ka nënshkruar me Komunën e Prishtinës dhe të Gjilanit pa procedura konkurruese.

Konstatojmë se Komuna e Pejës ka shpallur tender për ofrimin e shërbimeve të pagesave, në të cilin tender ka fituar IFJB VLLESA – CO.

Konstatojmë se në Komunën e Gjakovës përmes një Kontrate për qiranë e lokalit afaristë është instaluar Banka Ekonomike pa procedura konkurruese.

Konstatojmë se në Komunën e Ferizajt, kanë lidhur një Kontratë për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm me qira me IFJB VLLESA - CO, pa procedura konkurruese.

Konstatojmë se Komuna e Mitrovicës fillimisht ka zhvilluar procedura tenderuese-konkurruese me të cilën fitues është shpallur IFJB CAPITAL Sh.p.k., mirëpo me datën 15.10.2015 Komuna e Mitrovicës ka arritur Marrëveshje me Postën e Kosovës duke e vendosur në objektin e sajë për të ushtruar veprimtarinë ekonomike “shërbime të pagesave”. Kjo Marrëveshje është arritur pa procedura konkurruese.

Republika e Kosovës në bazë të Kushtetutës, është përcaktuar për ekonominë e lirë të tregut, të cilin në mënyrë eksplicite e garanton Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj favorizimi i një kompanie publike – nën kushte të njëjta të operimit me operatorë ekonomik tjerë privat, **pa bazë të përcaktuar ligjore**, e favorizon në këtë rast Postën e Kosovës Sh.A., përmes një Marrëveshje bashkëpunimi pa procedura konkurruese duke i ofruar ndarjen e një hapësire për ofrimin e Shërbimit të Pagesave në objektet e ARC-së në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe Komunat e institucionet tjera publike të cekura më lartë.

Konstatojmë se përmes këtyre marrëveshjeve të cilat bien ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, duke e favorizuar Postën e Kosovës ka rezultuar me ndryshimin e strukturës së gjendjes së tregut përkatës në ofrimin e shërbimeve të pagesave, pengim të qasjes së barabartë të konkurrentëve e që implementimi i mëtutjeshëm i këtyre marrëveshjeve mund të ç’orientoj konsumatorin në besimin se, ndërmarrjet e tjera që veprojnë në këtë treg me Postën e Kosovës janë jo të besueshëm.

Në letërkëmbimin elektronik, Posta e Kosovës kishte kërkuar nga KRPP interpretim për nenin 3 të Ligjit për Prokurim Publik, si më poshtë:

“A vlenë e njëjta rregull/dispozitë ligjore e prokurimit publik edhe në rastin e sigurimit të hapësirës fizike brenda objektit të Komunës së Prishtinës për një zyre postare për Postën e Kosovës”?

Përgjigjja e KRPP-së:

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik duke u bazuar në të dhënat e shkresës suaj, KRPP iu ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Paragrafi 6 i nenit 3 të këtij ligji, përcakton si në vijim:

"6. Ky ligj nuk aplikohet nga autoritetet kontraktuese për blerjen apo marrjen me qira, përmes çfarëdo metode të financimit, të tokës, objekteve ekzistuese apo pronave tjera të paluajtshme apo në lidhje me të drejta të tilla, përveç nëse me ligjet e veçanta është paraparë ndryshe".

Pasi që kjo rregull përjashton marrjen me qira të objekteve, atëherë kjo rregull vlen edhe për rastin tuaj konkret hapja e një zyre postare në objektin brenda Komunës së Prishtinës për ofrimin e shërbimeve për të cilat Posta e Kosovës është e licencuar të ua ofrojë qytetarëve të Kosovës.

Interpretimi i Nenin 3 paragrafi 6 të Ligjit të Prokurimit Publike nga ana e KRPP-së lidhur me përgjigjen e dhënë në pyetjen e parashtruar nga Posta e Kosovës me qëllim të arritjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit për të ofruar "Shërbime të Pagesave" për qytetarët e Republikës së Kosovës, për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, si i tillë **nuk vlen**, sepse Autoriteti Kontraktues i ka mundur me një Marrëveshje Postës së Kosovës që të vendoset në objektet publike pa procedura konkurruese, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike "Ofrimin e Shërbimeve të pagesave" e i cili akt i ka vendosur konkurrentët tjerë (IFJB) të tregut relevant në pozita të pafavorshme konkurruese. Për Autoritetin Kosovar të Konkurrencës ky veprim i autoriteteve kontraktuese përbënë shkelje ligjore të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 4 pika 1.4.

Njëherazi Posta e Kosovës është e licencuar nga BQK-ja për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike si IFJB, njëjtë sikur operatorët tjerë ekonomik të licencuar nga BQK-ja për shërbimet e njejta.

Në përmbajtjen e Marrëveshjes e lidhur ndërmjet MPB-së dhe Postës së Kosovës Sh.A. vërejmë se është potencuar ushtrimi i dy aktiviteteve: **aktivitetet postare dhe shërbime të pagesave**. Ndërsa faktet nga terreni dhe monitorimi në lidhje me hetimin paraprak tregojnë se Posta e Kosovës Sh.A. nuk ushtron aktivitete postare por vetëm shërbime të pagesave.

Bazuar në Rregulloren për Plotësimin e Rregullës së XVI për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtarinë e Institucioneve Financiare Jo bankare, Pika 8 (b) e kësaj rregullore thotë se: Veprimtarinë e Institucioneve Financiare Jo bankare - **Veprimtarinë e institucionit duhet të ushtrohen në zyrat ose lokalet që janë të identifikuar qartë, dhe të ndara prej veprimtarive të ndonjë aktiviteti tjetër komercial ose të ndonjë ndërmarrje**, që nënkupton se Posta e Kosovës Sh.A. është e vetëdijshme se nuk mund në të njëjtat lokale të ushtrojë veprimtari për të cilat është e pajisur me dy licenca të natyrave të ndryshme siç janë licenca për aktivitete postare e lëshuar nga ART-ja dhe licenca për shërbime të pagesave e lëshuar nga BQK-ja.

Interpretimi i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës është se nëse një lëndë e caktuar nuk bie nën dispozitat e Ligjit të caktuar atëherë, nuk do të thotë se apriori veprimi i caktuar është i lejuar sepse sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës përbëhet nga një tërësi ligjesh të cilat duhet të konsultohen paraprakisht para marrjes së një vendimi që mund të ketë impakte negative për

ekonomi e rrjedhimisht për konkurrencën nga ana e autoritetit shtetëror e sidomos kur kemi të bëjmë me funksionimin e një tregu konkurrues dhe të lirë.

E. VLERËSIMI I PASOJAVE MBI KONKURRENCËN NË TREG DHE AVOKIMI

Bazuar në detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit të AKK-së sipas Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës neni 28 paragrafi 1 pika 1.7 dhe 1.10 me të cilin Komisioni është i obliguar që në mënyrë aktive t'i promovojë njohurit për konkurrencën në treg, ngritjen e vetëdijësitimit dhe përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës efektive në treg.

Legjislacioni i hartuar nga organet e administratës qendrore ose nga iniciues të pavarur, pa u konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, mund të ketë pasoja negative mbi konkurrencën në treg.

Zbatimi i hapave kryesor analitikë në vlerësimet legislative ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së propozimit si dhe ndihmon për të shpjeguar nevojshmërinë e një veprimi apo në të kundërt demonstroi që nuk duhet të ndërmerret një veprim i caktuar legjislativ.

Neni 23 i Ligjit 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, e parasheh që organet e administratës qendrore dhe lokale, mund të kërkojnë vlerësimin apo mendimin profesional të Autoritetit për çdo ligj, projektligj ose akt-normativ që prek ndjeshëm konkurrencën në treg.

Vlerësimi *ex post* i ligjeve ekzistuese është detyrë e Autoritetit dhe pre supozon identifikimin e akteve normative në fuqi dhe analizën e pasojave mbi konkurrencën. Bashkëpunimi me rregullatorët sektorialë dhe autoritetet kompetente është i dëshirueshëm dhe në disa raste i domosdoshëm për kryerjen e këtij vlerësimi. Për vlerësimin e projekt-akteve normative, vlerësimi *ex ante*, është e domosdoshme që hartuesit e këtyre projekt ligjeve të bashkëpunojnë dhe të marrin parasysh **sugjerimet dhe rekomandimet** e dhëna nga Autoriteti Kosovar i Konkurrencës.

Mbrojtja dhe nxitja e konkurrencës

Sipas Kushtetutës së Kosovës, neni 10: *Ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës*. Si e tillë institucionet e shtetit e posaçërisht Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, si kategori Kushtetuese, është i obliguar ta zbatojë këtë dispozitë kushtetuese dhe Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Neni 119 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcakton qartë se: *“Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”*.

Integrimi i Kosovës në BE dhe standardet që dalin nga Rregulloret e Komisionit Evropian (Neni 101 i TFEU-së) që kërkohen të arrihen në këtë proces është një tjetër faktor përcaktues dhe nxitës për fushën e konkurrencës. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit, neni 74 dhe 75, shërbejnë si një katalizator për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të konkurrencës në përputhje me standardet dhe praktikave evropiane.

Një mjedis konkurrues siguron se do të ketë hyrës potencial në “garë” për të prodhuar një produkt të ri apo për të ofruar një shërbim më të mirë. Si pasojë, konkurrenca e fuqishme përbën nxitësin kryesorë të rritjes së produktivitetit dhe siguron që tregu do të mbetet konkurrues.

Nga një mjedis konkurrues i mirëfilltë jep mundësi të zgjedhjes, shërbime më të mira, cilësi, çmimet konkurruese dhe produktet të reja (inovacione).

Aktet normative duhet t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg, trajtimi i ndryshëm duhet të bazohet në kriteret objektive. Evitimi i favorizimit dhe krijimi i lehtësirave për ndërmarrjet e mëdha mundëson krijimit të ndërmarrjeve që zotërojnë fuqi tregu dhe pengon ndërmarrjet e tjera të jenë konkurruese në treg, e posaçërisht ato ndërmarrje që janë në të njëjtin nivel të operimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Për më shumë, organet shtetërore në të gjitha nivelet në vend të njoftohen se Autoriteti Kosovar i Konkurrencës është i obliguar sipas ligjit, që të jetë aktiv për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës nga ndërmarrjet nëse këto veprime kanë efekte në treg dhe në bazë të ligjit e rregullave të përcaktohet procedura, forma dhe metoda konkurruese për përzgjedhjen e një ose disa operatorëve ekonomik (IFJB) për ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe të tjera në objektet e MPB-ARC-së si dhe institucioneve tjera për të gjitha nivelet, qendrore dhe lokale.

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës PËRFUNDIMISHT me 3 vota afirmative vlerëson dhe konstaton se këto Marrëveshje/kontrata bien ndesh me LIGJIN Nr. 03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS neni 4 paragrafi 1.4 dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me këtë VENDIM të njoftohen:

- Kryeministri i Republikës së Kosovës – *Isa MUSTAFA*
- Kryetari i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri – *Muhamet MUSTAFA*
- Guvernatori i BQK-së – *Bedri HAMZA*
- Ministri i Punëve të Brendshme – *Skender HYSENI*
- Sekretari i Përgjithshëm i MPB – *Driton GASHI*
- Posta e Kosovës – *Sejdi HOXHA*
- Asociacioni i Komunave të Kosovës – *Naim ISMAJLI*
- IFJB-ve
- Arkivës

**KOMISIONI
AUTORITETI KOSOVAR I KONKURRENCËS**


Valon Prestreshi
Kryetar



()
Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Fatime Haziri
Anëtare

()
Muhamet Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar